

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Tel/Fax: +381 38 227 782; Mob: +377 44 622 000; info@noc-kosovo.org; www.noc-kosovo.org
Adresa: Rr. Agim Ramadani nr. 43, Shtëpia e Sporteve, kati I, nr. 10, 10000 Prishtinë, Kosovë

EKSTRAKT

Nga Mbledhja e 22 e BE te KOK, e mbajtur me 15.10.2014 ne ora 13,00

RENDI I DITES

PER MBLEDHJEN E RREGULLT TE BE TE KOK
(Prishtine, KOK, me 15 Tetor 2014, ora 13,00)

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga Mbledhja e 21 e BE te KOK, e mbajtur me 30.08.2014
2. Aktivitetet midis dy mbledhjeve te BE te KOK
 - a) Vizite pune ne KON, Lozane 1-10 Shtator 2014
 - b) Vizita e KOK ne KO te Gjermanise, 12.09.2014 (Besimi dhe Fatmiri)
 - c) Vizite pune ne KOKSH, 15.09.2014 (Besimi)
 - d) Panairi i Pare i Sportit "Prishtina 2014" e mbajtur me 25.09.2014
 - e) Vizite pune ne KOKSH, 13.10.2014 (Besimi)
 - f) Vizita e z. Samuel Zhbogar, perfaqesuesi special i BE ne Kosove dhe Ambasadores se Finlandes, znj. Anne Meskinen, me 14.10.2014
3. Pergatitjet per organizimin e Kursit per Administratore te sportit, ne Prishtine nga 28-30 Tetor 2014
4. Pergatitjet per Aplikim ne KON
5. Te ndryshme
 - a) Statusi i drejtuesve te sportit ne Kosove
 - b) Njoftimi me letren e Ministrit te MRS, z. Memli Krasniqi per Shperblimet e Perhershme
 - c) Ndryshime ne Rregulloren e 15/2013 per Shperblimet e sportistev e trajnereve.

Prezent: Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Fatmir Makolli, Artan Rugova, Shqipe Zogiani, Vjollca Krasniqi, Fadil Vokrri, Ramadan Selimi, Nezir Rama dhe Ismail Kasumi.

Munguan: Arben Lila dhe B.Grbic (pa arsye)

HAPJA E MBLEDHJES:

Besim Hasani, President i KOK, hapi mbledhjen e 22 te BE te KOK dhe propozoj Rendin e Dites me larte. R.Selimi, Sh.Haxhijaj dhe Fatmir Makolli, nen piken te ndryshme propozuan temat ne vijim per te cilat u vendos te futen ne Rend te dites (Pergatitja e bexhave per BE te KOK te cilat do te mundesonin qasje ne stadiume dhe halla te sporteve, ndarja e shperblimeve per sportistet e shekullit, plotesimi i rregullores per shperblime, duke ndare shperblimin per trajnere midis trajnerit te kombetares dhe trajnerit te klubit/sportistit per sportet individuale, definimi i kohes se mbajtjes se asamblese se rregullte te KOK.

PIKA 1.

Ekstrakti nga Mbledhja 21 u miratua njezori me permiresimin per prezencen e Ramadan Selimit ne mbledhjen 21 (ishte gabim teknik).

PIKA 2.

- a) Besim Hasani njoftoj per takimet e tij ne Lozane me Presidentin Bach, me Pere Miron dhe Jerome Poivey dhe bisedat e shumta ne akordimin per aplikimin e KOK ne KON, per nevojen e konfidencialitetit dhe plotesimit te fajlit per aplikacion sipas kriterëve te parapara me Karten Olimpike ne fuci. Te gjithë ju gezuan faktit se KOK do te jete ne agjenden e Mbledhjes se BE te KON e planifikuar te mbahet me 22 e 23 Tetor 2014. BE i KOK u njoftua me permbajtjen e fajlit dhe nevojen e shtypjes se tij ne forme te librit.
- b) Besim Hasani dhe Fatmir Makolli njoftuan per takimin e tyre me Presidentin e KO e Sportiv te Gjermanise, z. Alfons Herman, ne Berlin me daten 12 Shtator 2014. Takimi u konsiderua shume premtues. Presidenti Herman premtoj se perfaqesuesit e Gjermanise ne Federatat Nderkombetare do te ndihmojne per njohjen e Federatave te Kosoves dhe te KOK, do te ndihmojne me pajisje sportive dhe me eksperte per ngritjen e kapaciteteve ne Federatat e Kosoves dhe ne KOK si dhe per trajnere e sportiste. Z. Hasani mori miratimin e BE te KOK per te kerkuar nga KO i Gjermanise nje ekspert per qendrim afatgjate ne KOK per aplikim ne projektet e Solidaritetit Olimpik dhe per aftesimin e nje te riu i cili apo e cila duhet te punesohet nga fillimi i vitit 2015. U vleresua roli ndermjetesues i zonjes Megi Maass Shala midis KOK dhe KO te Gjermanise.
- c) Besim Hasani njoftoj edhe per dy takime zyrtare ne KOKSH dhe caktimin e kohes per mbajtjen e Kursit per administratore te sportit, qe planifikohet te mbahet tre dite (nga 28-30 Tetor 2014) ne Boge apo Prevalle.
- d) Panairi i Pare i Sportit "Prishtina 2014" u vlersua nga te gjithë si nje storje e sukseshme dhe me efekte te dobishme per rritjen e numrit te te rinjeve qe do te merren me sport. U falenderuan Federatat pjesemarrese dhe kontributi i Drejtorise

per Arsim i Komunes se Prishtines qe kishte liruar femijet e cerdheve dhe te SHF qe ne menyre te organizuar te vizitojne Panairin.

U tha se per shkak te efekteve duhet te organizohet tradicionalisht por edhe te mbahet edhe ne Komunitat tjera!

- e) Samuel Zhbogar i shoqeruar nga Ambasadorja e Finlandes ne Kosove, zonja Anne Meskinen me daten 14.10.2014 vizituan KOK. Nga ky takim, zyrja e BE ne Kosove ka leshuar informaten me shkrim dhe ua ka derguar mjeteve te informimit. Kjo informate do te jete pjese e ketij ekstarakti. Sidoqofte nga anetaret e BE ky takim u vleresua pozitivisht dhe u tha se raportet e mira duhet te kultivohen me tej ne funksion te bashkepunimit me intenziv me zyren e BE dhe Ambasadat tjera ne Kosove!

PIKA 3.

Besim Hasani informoj BE te KOK se eshte marrur vendimi, bazuar ne Memorandumin e nenshkruar midis KOK dhe KOKSH dhe ne Planin e punes se KOK per vitin 2014, te mbahet Kursi i Dyte per Administratoret e sportit me daten 28,29 dhe 30 Tetor 2014, rekomandohet qe ky Kurs te mbahet ne Prevalle ose ne Boge ku do te punohet 3 dite dhe dy nete do akomodohemi. Ligjeruesit jane profesoret qe kane kryer MEMOS (Masterin per Menaxhimin e Organizatave Sportive Olimpikike me cka e kane fituar te drejten qe ne emer te KON-it te organizojne Kurse bazike dhe te avansuara per administratore te sportit.

Ne ditet ne vijim do te informohen te gjitha federatat qe te dergojne perfaqesuesin e tyre ne kete kurs. Grupi i administratoreve do te permbaje 20 persona.

PIKA 4.

Besim Hasani njoftoj BE te KOK per biseden e zhvilluar ne Lozane me Presidentin Thomas Bach, me Drejtorin per relacione me KO Kombetare z. Pere Miro dhe sekretarin e kesaj drejtorie z. Jerome Poivey dhe marreveshjen per pergatitjen e fajlit per aplikim te KOK ne KON. Kerkesa e KOK do te jete ne agjenden e Mbledhjes se BE te KON e pararpare te mbahet me 22 dhe 23 Tetor 2014. Ky lajm kaq domethenes per sportistet, trajneret dhe drejtuesit e sporteve ne Kosove per momentin eshte konfidencial!

Fajli per aplikim, me e-mail eshte derguar ne KON me daten 10 Tetor 2014 ndersa ne kopje te forte dhe ne forme te librit do te dergohet me DHL me daten 17 Tetor 2014. BE pati rastin me pa nje kopje te tille dhe u premtua se do te kete kopje te mjaftueshme per anetaret e Sesionit te KON, te cilet do te takohen ne mbledhjen e Jashtezakonshme te Sesionit qe do te mbahet ne Monako nga 7-9 Dhjetor 2014, ku pritet qe KOK te pranohet ne KON me te drejta te plota dhe perfundimisht sportistet e Kosoves te perfaqesojne Kosoven ne Lojera Olimpikike.

Kesaj infomate ju gezuan te gjitha dhe mirepritet kjo dite per te bere nje feste ne tere Kosoven ne proporcion me rendesine e kesaj ngjarje!

PIKA 5.

- a) Statusi i drejtuesve te sportit duhet te vleresohet, te cmohet dhe te shperblehet ne raport me kontributin edhe ne nga Pavaresimi i sportit deri ne ditet e sotme. U theksua nevoja e pranimit te stazhit gjate viteve 1991-1999 dhe ne kete drejtim u formua Komisioni ne perberje: Vjollca Krasniqi kryetare dhe Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Ismail Kosoumi dhe Nezir Rama, anetar. Ky Komision do te angazhohet ne gjetjen e formave adekuate per te rregulluar statusin e drejtuesve te sportit. Ne kete drejtim u be nderlidhja e nenpikes per rregullimin e bexhave per BE te KOK qe do te mundesonte qasje te papenguar dhe hierarkike ne Stadiume, ne Palestra sportive dhe ne objekte tjera sportive ne tere Kosoven. U formua Komisioni ne perberje: Ramadan Selimi, Fatmir Makolli dhe Besim Hasani per zgjedhjen e dizajnit te bexhit.
- b) Ne vijim u diskutua per plotesim ndryshimin e Rregullores të MKRS me nr 14 e 15/2014 te miratuar nga Qeveria e Kosoves per shperblime te perhershme qe ne mesin atyre te jene edhe "Sportiste e shekullit" (propozim i Fatmir Makolli), qe ne sportet individuale i shperblyer mos te jete vetem trajneri i Kombetares por edhe i klubit respektivisht i sportistit. Madje pati propozime qe te Rregullorja te behet e re dhe me gjithepershires. Nisur nga fakti se tere keto pika moren mjaft kohe dhe per to duhej diskutuar me gjeresisht u vendos qe ne Mbledhjen e rradhes te BE te KOK, nje pike e vecante te jete Rregullorja nr.....
- c) Per kohen e mbajtjes se Asamblese se KOK u vendos qe kjo te mbahet pas Mbledhjes se Sesionit te 127 te KON, pra pas 9 Dhjetorit 2014, me nje bindje se kjo Asamble perpos karakterit te punes do te kete edhe karakter solemn, bazuar ne ne faktin se pritet qe deri atehere KOK te njihet nga KON. Normalisht mbeti e hapur mbajtja e Asamblese menjehere pas Mbledhjes se BE te KON e parapare per 22 e 23 Tetor 2014, nese kerkohet miratimi i Statutit te ri te KOK i pranuar nga KON.

Mbledhja perfundoj ne 15:15

Ekstarkti u perpilua nga Besim Hasani bazuar ne Procesverbaline mbajtur nga Jeton Rudari